

407
LIBRA

Partia “Lista e Barabartë” - LIBRA

Raport i Audituesit të Pavarur Për Qëllime të Veçanta

PËR AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA PËR
VITIN KALENDARIK 2016

Margarita Kalemasi E.K.R

Tabela e përmbajtjes

A. RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	2
B. PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	4
C. PASQYRA E PERFORMANCËS.....	4
D. PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE.....	5

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

PËR AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA PËR VITIN KALENDARIK 2016

Drejtuar: Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ), Tiranë,
Partisë "Lista e Barabartë" - LIBRA, Tiranë.

Të nderuar zotërinj,

Në cilësinë e Ekspertes Kontabël të Regjistruar, bazuar në Vendimin e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve ("KQZ"), Nr. 196, datë 03.05.2017 si dhe Kontratën e Shërbimit Nr. 5484/10 Prot. datë 13.09.2017 të lidhur me këtë institucion; Ne kemi audituar pasqyrat financiare për fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga Partia "Lista e Barabartë"-LIBRA për vitin kalendarik 2016.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare të Fondeve të Përfituara dhe të Shpenzuara për vitin kalendarik 2016, janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK-të) dhe Ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare.

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK-të), Ligjin Nr. 8580 datë 17.02.2001 "Për Partitë Politike" i ndryshuar, si edhe Ligjin Nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".

Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo pasaktësia; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura kontabël dhe bërjen e vlerësimeve kontabël që janë të përshtatshme për rrethanat.

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion për këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Këto Standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikes dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qellim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi përfshin procedura për të marrë prova auditimi për vlerat dhe paraqitjen në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë dhe vlerësimin e riskut të egzistencës së gabimeve materiale në pasqyrat financiare, qofshin rezultat i mashtrimeve apo pasaktësira. Në bërjen e këtyre vlerësimeve, audituesi konsideron kontrollin

e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga drejtuesit si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë ofron baza të arsyeshme për dhënie të opinionit të auditimit.

Eksperte Kontabël e Regjistruar

Zj. Margarita Kalemasi

Liçensë Nr. 156, datë 08.06.2006



Tiranë, më 25/10/2017

Rr. Asim Vokshi,

Nd. 14, H. 6, Ap. 27,

Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 42420666

Cel: +355 69 571 3335

email: m.kalemasi@joncon.al

Pasqyra e Pozicionit Financiar për periudhën nga 01 Nëntor deri më 31 Dhjetor 2016

AKTIVET	Shënime	Për periudhën nga 01 Nëntor 2016 deri më 31 Dhjetor 2016
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	4	32,840
Të drejta të arkëtueshme	5	1,500
Aktivitet Afatgjata Materiale	6	392,500
Totali i aktiveve		426,840
DETYRIMET		
Grante dhe kontribute të anëtarëve	7	1,357,800
Shpenzime të periudhës		(930,960)
Totali i detyrimeve dhe fondeve të veta		426,840

Pasqyra e Performancës për periudhën nga 01 Nëntor deri më 31 Dhjetor 2016

Përshkrimi i zërit	Shënime	Për periudhën nga 01 Nëntor 2016 deri më 31 Dhjetor 2016
Ndryshimi në aktivet neto të pakufizuara:		
Të ardhurat:	7	930,960
Të ardhurat nga tarifat e anëtarësimit		113,960
Të ardhurat nga donacionet		563,500
Të ardhurat nga investimet apo dhurimet		253,500
Shpenzime për aktivitetet		
Aktiviteti		(708,472)
Shpenzime administrimi dhe të tjera të përghithshme		(222,488)
Totali i detyrimeve dhe fondeve të veta	8	(930,960)

**Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare për
periudhën nga 01 Nëntor deri më 31 Dhjetor 2016**

	Shënime	Për periudhën nga 01 Nëntor 2016 deri më 31 Dhjetor 2016
AKTIVET E SHFRYTËZIMIT		
Ndryshimi në aktivet neto		
Rritje/Rënie në të hyrat nga donatorë		253,500
		173,340
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet afatshkurtra:		
Të tjera të arkëtueshme		(1,500)
Flukse neto nga aktivitetet e shfrytëzimit		425,340
AKTIVITETET INVESTUESE		
Blerje/Shitje e Aktiveve Afatgjata		(392,500)
Flukset neto nga aktivitetet investuese		(392,500)
AKTIVITETET FINANCUERE		
Rritje/Renie neto e mjeteve monetare		32,840
Mjete monetare në fillim të periudhës		-
Mjete monetare në fund të periudhës	4	32,840